



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 106/prot.
16

Tiranë, më 28.01.2021

V E N D I M

Nr. 10 datë 28.01 2021

**MBI MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE DHE ANALITIKE TË
UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS
DHE KLASIFIKIMIN E PAGËS,
PËR VITIN 2021.**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", neni 49, Statuti i UST, neni 43, në VKM nr.123 datë 17.02.2010 "Për krijimin e Universitetit të Sporteve të Tiranës", në Urdhërin e MASR me nr. 495, datë 11.10.2019 "Për hapjen e njësisë kryesore Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit, në Universitetin e Sporteve të Tiranës", VKM nr. 268, datë 29.03.2017 "Për disa ndryshime në VKM nr. 748, datë 11.06.2009 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të personelit akademik të institucioneve publike të Arsimit të Lartë" i ndryshuar, Vendimin nr.187, datë 08.03.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve", VKM nr.329 datë 12.04.2017 "Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik", në Udhëzimin e MASR nr.29 dt. 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet publike të Arsimit të Lartë", në VKM nr.202, dt.15.03.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.717, datë 23.06.2009 të KM, "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore" të ndryshuar, Vendimin e Senatit nr. 4 datë 22.01.2021 "Mbi miratimin e propozimit për strukturën organizative dhe analitike të UST dhe klasifikimin e pagës, për vitin 2021", Bordi i Administrimit në mbledhjen e tij të datës 28.01.2021,

V E N D O S I:

1. Miratimin e strukturës organizative, analitike dhe klasifikimin e pagës sipas pozicioneve, në Universitetin e Sporteve të Tiranës, për vitin 2021, sipas tabelës bashkëngjitur.

2. Efektet financiare për mbulimin e pagave të stafit efektiv akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe administrativ të përkohshëm të mbulohen nga buxheti i Universitetit të Sporteve të Tiranës, i detajuar për vitin 2021.
3. Struktura e plotë e Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit do të plotësohet brenda dy viteve 2021-2022.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Rektorati i Universitetit të Sporteve të Tiranës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al dhe tek trasparenca universitare.

KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

HYSEN DOMI

